



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/194
Datë: 20.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për mbulim të trajtimit mjekësor të personave me status të invalidit të luftës për qëllim të ndërrimit, mirëmbajtjes apo vendosjes së protezave, jashtë institucioneve shëndetësore publike, kur këto të fundit nuk ofrojnë këto shërbime.
2. Mjetet financiare për zbatimin e këtij Vendimi shfrytëzohen nga buxheti i Programit për trajtimin mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike (FSSh).
3. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore për zbatimin e këtij Vendimi, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/194
Datë: 20.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 95, paragrafit 2. të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafit 1. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet lista e artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik, e aprovuar sipas pikës 1. të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30 prill 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 07/140 të datës 26 prill 2023 dhe me Vendimin Nr. 13/148 të datës 29 qershor 2023, me listën e bashkëngjitur në Shtojcën 1. të këtij Vendimi.
2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30 prill 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 07/140 të datës 26 prill 2023 dhe me Vendimin Nr.13/148 të datës 29 qershor 2023, mbesin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I

Artikujt dhe Shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta

Përshkrimi i artikullit	Lloji i kontratës	Kohëzgjatja
1. Furnizim me letër për kopje	Kontratë Kornizë	2 Vite
2. Furnizim me material zyrtar	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
3. Furnizim me vetura të udhëtarëve	Kontratë Kornizë	1 Vit
4. Furnizim me artikuj ushqimor	Kontratë Kornizë	1 Vit
5. Furnizim me mobile	Kontratë Kornizë	1 Vit
6. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
7. Furnizim me pemë dhe perime (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
8. Veturat me qira	Kontratë Publike Afatgjate	5 Vite
9. Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Kontratë Publike Afatgjate	3 Vite
10. Furnizim me karburante	Kontratë Kornizë	1 Vite
11. Furnizim me mazut	Kontratë Kornizë	2 Vite
12. Furnizim me ujë të pijes	Kontratë Kornizë	3 Vite



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/194
Datë: 20.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni ad hoc për vlerësimin profesional për përzgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë.
- Komisioni ka këtë përbërje:
 - Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, kryesuese;
 - Venera Çerkini, Drejtore Ekzekutive në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë /MBPZhR anëtare;
 - Xheladin Krasniqi U.D. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - Shenaj Hoxha U.D. Udhëheqëse e Burimeve Njerëzore, anëtare;
 - Egzzone Osmanaj, Eksperte e jashtme, anëtare.
- Obligohet Komisioni ad hoc si nga pika 2. e këtij Vendimi që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij siç përcaktohet me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë dhe Rregulloren Nr. 05/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë